

URDHËR
Nr. 31, datë 25.6.2013

PËR REVOKIMIN E URDHËRIT NR. 9, DATË 10.3.2005 TË MINISTRIT TË FINANCAVE “PËR SEKUESTRIMIN E PASURIVE TË FONDACIONIT “TAIBAH INTERNATIONAL”, E NJOHUR SI SHOQATA NDËRKOMBËTARE E NDIHMAVE, I CILI REZULTON I SHPALLUR NË LISTËN E FINANCUESVE TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 121 pika 1, 124 dhe 125 të Kodit të Procedurave Administrative dhe në zbatim të ligjit nr. 9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ligjit nr. 8865, datë 14.3.2002 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për Luftën kundër Financimit të Terrorizmit e vitit 1999”,

URDHËROJ:

1. Revokimin e urdhrit nr. 9, datë 10.3.2005 të Ministrit të Financave “Për sekuestrimin e pasurive të fondacionit “Taibah International”, e njohur dhe si Shoqata Ndërkombëtare e Ndihmave, i cili rezulton i shpallur në listën e financuesve të terrorizmit”, të ndryshuar me urdhrat nr. 20, datë 13.6.2006 dhe nr. 29, datë 5.7.2006.

2. Ky revokim përfshin të gjitha fondet, llogaritë, asetet, pasuritë e paluajtshme, trojet, investimet në shoqëri tregtare dhe mjetet financiare në emër të fondacionit “Taibah International”, e njohur si Shoqata Ndërkombëtare e Ndihmave të sekuestruara me urdhrat e parashikuar në pikën 1.

3. Për lirimin dhe dorëzimin e pasurive të revokuara me këtë urdhër, të ngrihet një grup pune në përbërje të të cilit të ketë përfaqësues nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode